Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0234

0234/2025

0248/2025

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Vedat Poterqoi Anetar dhe Batisha Ibrahimi Anetare duke vendosur sipas ankesës së OE Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K. dhe EKSIM COM SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Vendimin për dhënie të një k lidhur me aktivitetin e prokurimit "Riparimi i Kushinetave të Dyfishta në B1&B2 – Tc "Kosova B" me numër të prokurimit KEK-24-10314-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.., më 28/05/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohen, si te pabazuar ankesa e Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K. 2025/0234 , e datës 04/04/2025., dhe EKSIM COM SH.P.K. me nr. 2025/0248 , e datës 07/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Riparimi i Kushinetave të Dyfishta në B1&B2 – Tc "Kosova B"" me numër të prokurimit KEK-24-10314-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. për aktivitetin e prokurimit "Riparimi i Kushinetave të Dyfishta në B1&B2 – Tc "Kosova B" me numër të prokurimit KEK-24-10314-5-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.10.2024, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi i Kushinetave të Dyfishta në B1&B2 – Tc "Kosova B"" me numër të prokurimit KEK-24-10314-5-2-1.Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 350,000.00 €.

Me 18.03.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie te kontratës ku ka shpërblyer me kontrate OE ELSAM SHPK.

Me 21.03.2025, OE Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K.., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin te AK të cilën AK e ka refuzuar me datën 28.03.2025.

Me datë 24.03.2025 po ashtu edhe OE EKSIM COM SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin te AK te cilën AK e ka refuzuar me datën 28.03.2025.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2025/0234 e datës 04.04.2025, si dhe OE ankues EKSIM COM SH.P.K.., ka parashtruar ankesë me nr. 2025/0248 të datës 07.04.2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0234/2025 dhe ankesa nr. 0248/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K.

Me datën 21.03.2025, Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka pranuar kërkesën për rishqyrtim në mënyrë elektronike të parashtruar nga OE Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: RIPARIMI I KUSHINETAVE TË DYFISHTA NË B1&B2 -

TC "KOSOVA B", me nr. prokurimit KEK-24- 10314-5-2-1 Konform nenit 108/A, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit të Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, komisioni profesional vlerësues i Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon: Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, komisioni e ka shqyrtuar atë dhe vlerëson se pretendimet e OE ankuesit nuk qëndrojnë. Komisioni ka vepruar në përputhje me LPP-në dhe ka vlerësuar të gjitha ofertat duke zbatuar të njëjtin standard dhe duke u bazuar ne kërkesat e dosjes se tenderit. OE ankues Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K, edhe në kërkesë për rishqyrtim e pranon se nuk e posedon Certifikatën 1090 e cila është kërkesë e dosjes se tenderit njeherit edhe gjate fazës se pyetjeve sqaruese ka bere kërkesë qe të hiqet kjo Certifikatë dhe përgjigja e AK ka qene qe certifikata duhet te dorëzohet. Si përfundim OE nuk ka plotësuar kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale konkretisht certifikatën ne fjale te cilën përfundimisht edhe ne kërkesë për rishqyrtim e konfirmon se nuk e posedon. Sa i përket ankesës për certifikatat e salduesve Certifikatat e saldueseve nuk janë te vazhduara sipas standardit ISO 9606-1 ku pika 9.2 e këtij standardi thotë se " Certifikatat nuk janë valide ne rast te mos konfirmimit për çdo gjashtë muaj, ku konsiderohet se salduesi nuk është i aftë për të salduar". OE ankues nuk i ka të konfirmuara çdo gjatë muaj certifikatat e salduesve ashtu siç e kërkon standardi. Standardi është ai që e përcakton validitetin e certifikatës. Foto ku shihet tabela e pa plotësuar te cilën OE e ka dorëzuar ne oferte. Çdo ndryshim material duke plotësuar ofertën nga OE gjate kërkesës për rishqyrtim nga oferta fillestare është i papranueshëm. Sa i përket pikës ankimore për referencë: Referenca është lëshuara nga një kompani për prodhimin e blloqeve(Tullave) dhe nuk konsiderohet e ngjashme, ku ka dallim shumë të madh në mes të mullinjeve të Termocentralit Kosova B që prodhojnë 339MW energji elektrike dhe mullinjve të një fabrike për prodhimin e blloqeve (tullave). Si përfundim komisioni konsideron se referenca nuk është adekuate.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit EKSIM COM SH.P.K.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vlerësuar ofertat në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit:

Me datën 24.03.2025, Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka pranuar kërkesën për rishqyrtim në mënyrë elektronike të parashtruar nga OE EKSIM COM SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: RIPARIMI I KUSHINETAVE TË DYFISHTA NË B1&B2 - TC "KOSOVA B", me nr. prokurimit KEK-24-10314-5-2-1 Konform nenit 108/A, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit të Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, komisioni profesional vlerësues i Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, komisioni e ka shqyrtuar atë dhe vlerëson se pretendimet e OE ankuesit nuk qëndrojnë. Komisioni ka vepruar në përputhje me LPP-në dhe ka vlerësuar të gjitha ofertat duke zbatuar të njëjtin standard dhe duke u bazuar ne kerkesat e dosjes se tenderit. Lidhur me validitetin e ofertes: OE ankues eshte duke ju referuar rregullores se vjeter per Prokurim Publik ndersa me rregulloren e re eshte bere modifikimi i nenit 30.4. ku sipas ketij ndryshimi eshte e rendesishme qe te kerkohet validiteti pa specifikuar periudhen se kur. Si rrjedhoje ju informojme se sipas kerkeses qe kemi bere per te gjithe OE pjesemarres, te gjithe jane pergjigjur pozitivisht duke bere vazhdimin e validitetit te ofertes (bashkangjitur gjeni vazhdimin e validitetit nga OE i propozuar) Sa i përket pretendimit ankimor për certifikatat e salduesve: Certifikatat e saldueseve

nuk janë te vazhduara sipas standardit ISO 9606-1 ku pika 9.2 e këtij standardi thotë se " Certifikatat nuk janë valide ne rast te mos konfirmimit për çdo gjashtë muaj, ku konsiderohet se salduesi nuk është i aftë për të salduar". OE ankues nuk i ka të konfirmuara çdo gjatë muaj certifikatat e salduesve ashtu siç e kërkon standardi. Standardi është ai që e përcakton validitetin e certifikatës. Sqarim shtesë: në D.T është kërkuar certifikata salduesve sipas standardit ISO 9606-1 pjesë e këtij standardi janë nenet që duhet plotësuar për të qenë certifikata valide ne kete rast certifikatat e salduesve sipas Standardit ISO9606-1 për të qenë valide duhet të plotësohen të gjitha nenet e këtij standardi, si rrjedhoje OE ankues nuk i ka plotesuar pasi qe certifikatat e saldueseve nuk janë te vazhduara sipas standardit ISO 9606-1 ku pika 9.2 e këtij standardi thotë se" Certifikatat nuk janë valide ne rast te mos konfirmimit për çdo gjashtë muaj, ku konsiderohet se salduesi nuk është i aftë për të salduar". Foto ku shihet tabela e pa plotësuar te cilën OE e ka dorëzuar ne oferte. Çdo ndryshim material duke plotësuar ofertën nga OE gjate kërkesës për rishqyrtim nga oferta fillestare është i papranueshëm. Pretendimi ankimor lidhur me punetoret: • Në DT është kërkuar 10 punëtorët, te dëshmohet me CV, kopje te diplomës se shkollës se mesme dhe kontrate pune apo para kontrate. Ne dokumentacionit, kompania ne fjale ka ofruar diplomat dhe vërtetimin mbi sigurimin social te obligueshëm, por nuk ka ofruar CV-të dhe kontratat për 10 Punëtoret i gjithë dokumentacioni është në gjuhën serbe çerilicë. Në dosjen e tenderit është kërkuar inxhinier i diplomuar të makinerisë, të dëshmohet me CV, kopje të diplomës dhe kontratë pune ose para kontrate. Kompania ne fjale nuk ka ofruar CV per inxhinierin e diplomuar te makinerisë dhe kontratën e punës.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I): “Pika 1 – Mungesa e Certifikatës EN ISO 1090. Ne këtë pretendim ankimore OE pranon mungesën e certifikatës EN ISO 1090, por pretendon se ajo nuk është relevante për natyrën e punës (riparim mekanik, jo konstruksione çeliku). Thekson përvojën me projekte të ngjashme dhe posedimin e certifikatave tjera relevante (ISO 9001, 14001, 45001, 3834-2), duke kërkuar që mungesa e ISO 1090 të mos jetë arsye për eliminim.”

Pretendimi i dyte (II): “Pika 2 Certifikatat e pavlefshme të salduesve. Ne këtë pretendim ankimor OE ankuese pretendon se Certifikatat e prezantuara nga ana jone jane valide deri me date 23.11.2025 , mirëpo për arsye teknike ka ndodhur një gabim gjate bashkëngjitjes ne platforme te certifikatave sepse ne gabimisht i kemi bashkangjitur certifikatat e vjetra dhe jo ato te plotësuarat pasi qe ne si kompani kemi kryer te gjitha procedurat e nevojshme sipas standardit nga Koordinatori ynë i kontraktuar z Jeton Gashi I diplomuar dhe person i autorizuar për te kryer kontrollet e nevojshme sipas standardit ISO3834-2. OE ankues pretendon se AK-ja ka bere shkelje te nenit 72 te ligjit te prokurimit pasi qe për piken ne fjale nuk ka dëshmi shtese ose kërkesë për sqarim lidhur me validitetin ne certifikatat tona.”

Pretendimi i trete (III) : “Pika 3: Referencat më të vjetra se 3 vite nga data e publikimit te njoftimit për kontratë. Në këtë pretendim, OE ankues kërkon që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë dosjen e tij, duke theksuar se posedon përvojë relevante dhe kapacitete të mjaftueshme teknike e profesionale për realizimin e kontratës. Megjithëse vetë pranon se nuk ka paraqitur referenca brenda afatit kohor prej 3 vitesh, siç kërkohet në dosjen e tenderit, OE

thekson se ka realizuar projekte të ngjashme më parë – në vitet 2014, 2016 dhe 2018 – të cilat, sipas tij, dëshmojnë aftësinë për riparimin e kushinetave të dyfishta, të kërkuara në këtë aktivitet."

Pretendimi i katër (IV) : "Ne këtë pretendim ankimor OE ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht për shkak të përdorimit të standardeve të dyfishta nga Autoriteti Kontraktues. Si argument, theksohet se në një tender të ngjashëm të shpallur më 18.12.2024 për termocentralin Kosova A, nuk janë kërkuar as certifikata ISO 1090, as certifikata të salduesve, CV apo diploma të stafit – ndërsa në tenderin aktual të TCB-së, këto janë kërkuar. OE konsideron se kjo përbën favorizim dhe kufizim të konkurrencës, duke vendosur kritere jo relevante, pasi ISO 1090 lidhet me konstruksione çeliku në ndërtimtari, jo me industrinë mekanike apo riparimin e kushinetave. Sipas tyre, standardi përkatës në këtë rast do të ishte ISO 3834 dhe certifikimet për salduesit."

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eksim Com Sh.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I): "OE ankues pretendon se është eliminuar në mënyrë të padrejtë nga Autoriteti Kontraktues për shkak të mungesës së dokumentacionit për 10 punëtorë, duke u theksuar si arsye mungesa e CV-ve dhe kontratave të punës. Sipas OE ankuesit, ky vlerësim nuk qëndron, pasi janë dorëzuar dëshmi për 16 punëtorë, përfshirë: kontratat e punës, librezat e punës dhe fotokopjet e letërnjoftimeve. Të gjitha të dhënat janë të plota dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Gjithashtu, janë bashkëngjitur edhe dëshmi nga Regjistri Qendror i Sigurimit, të cilat konfirmojnë marrëdhënien e përhershme të punësimit. Si shembull, për punëtorin Branislav Vaic janë dorëzuar të gjitha dëshmitë që tregojnë se ai është i punësuar që nga viti 2019 me kontratë të përhershme në Termooprema d.o.o."

Pretendimi i dyte (II) : "Në këtë pretendim ankimor, OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues gabimisht ka vlerësuar se mungojnë CV-ja dhe kontrata e punës për inxhinierin e diplomuar. OE ankues e kundërshton këtë vlerësim duke pretenduar se ka dorëzuar dëshmi të plota për dy inxhinierë të diplomuar të makinerisë. Për secilin prej tyre janë përfshirë: kontrata e punës, libreza e punës dhe fotokopje e letërnjoftimit. Të dhënat e paraqitura janë zyrtare, të përditësuara dhe të verifikueshme përmes regjistrit qendror të sigurimeve. Si shembull, për inxhinierin Petar Calie janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse që dëshmojnë përvojën e tij profesionale dhe marrëdhënien e përhershme të punës që nga viti 2015."

Pretendimi i trete (III): "OE ankues kundërshton vlerësimin e Autoritetit Kontraktues se certifikatat e salduesve nuk janë valide për shkak se nuk janë rinovuar çdo gjashtë muaj, sipas pikës 9.2 të standardit ISO 9606-1. OE pretenduar se ka paraqitur certifikata valide për pesë saldues, të lëshuara sipas standardit SRPS EN ISO 9606-1 nga trupi akreditues Weld-ing. Këto certifikata janë të verifikueshme në mënyrë të pavarur përmes QR kodit në faqen zyrtare dhe

janë të listuara në regjistrin publik të salduesve të certifikuar. Secili prej salduesve është në marrëdhënie të rregullt pune dhe ka dokumentacion të plotë shoqërues. Si shembull, për Nebria Srecko certifikata është valide deri më 29.05.2025, për Kalicanin Bojan deri më 29.10.2025, ndërsa edhe Petreski Miroslav dhe Pesic Aleksandar posedojnë certifikata të vlefshme."

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10/04/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0234/2025 ndërsa me datë 23/04/2025 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/04/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0248/2025 ndërsa me datë 23/04/2025 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesat nr. 0234/2025 dhe 0248/2025 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 0234/2025 të operatorit ekonomik Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K

Përgjigje ne pretendimin ankimor 1- Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme pretendimin ankimor dhe ka vlerësuar kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nga shqyrtimi rezulton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP-së, kur ka konstatuar se mosdorëzimi i certifikatës EN ISO 1090 përbën mosplotësim të kërkesave të kualifikimit, ashtu siç ishin të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate.Pavarësisht vlerësimit subjektiv të OE-së për rëndësinë e kësaj certifikate, ajo ka qenë kriter i qartë, objektiv dhe i detyrueshëm për të gjithë operatorët ekonomikë.Prandaj, eliminimi i OE-së është bërë në mënyrë të drejtë dhe ligjore dhe ne këtë pikë pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje ne pretendimin ankimor 2- Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme pretendimin ankimor dhe ka vlerësuar kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nga shqyrtimi rezulton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP-së ,pasi qe dorëzimi i dokumenteve të pasakta, përfshirë certifikata të skaduara apo të papërshtatshme, është përgjegjësi e plotë e OE-së. Gabimet teknike nuk e përjashtojnë këtë përgjegjësi. Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë i obliguar të kërkojë sqarime shtesë për dokumente jo të rregullta. AK ka vepruar në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së. Prandaj, pretendimi konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje ne pretendimin ankimor 3- Eksperti shqyrtues ka vlerësuar pretendimin dhe dokumentacionin përkatës dhe konstaton se OE ankues nuk ka dorëzuar referenca brenda

periudhës së kërkuar prej tre (3) viteve, siç është përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit. Edhe pse OE pretendon se përvojat më të vjetra (nga vitet 2014, 2016 dhe 2018) janë të ngjashme dhe dëshmojnë kapacitetet e tij, neni 69.6.2 i Ligjit për Prokurimin Publik i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën të kërkojë referenca brenda një periudhe të caktuar kohore.Meqë ky kufizim ka qenë i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit dhe zbatohet njësoj për të gjithë ofertuesit, mosplotësimi i tij përbën mos përmbushje të kërkesave esenciale të tenderit. Prandaj, pretendimi konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4 –Standardet e dyfishtaEksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin dhe dokumentacionin përkatës dhe konstaton se çdo aktivitet prokurimi trajtohet në mënyrë të veçantë, me kërkesa teknike që përcaktohen në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e projektit. Prandaj, fakti që në një tender tjetër nuk janë kërkuar certifikata të caktuara, nuk e bën të vlefshëm pretendimin për trajtim të pabarabartë në këtë rast specifik.Gjithashtu, sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik, janë përcaktuar qartë afatet dhe format për paraqitjen e kërkesave për rishqyrtim ose ankesave, në rastet kur operatorët ekonomikë konsiderojnë se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kushte diskriminuese, favorizuese ose jo proporcionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Nëse një operator nuk ka ushtruar të drejtën e tij brenda këtyre afateve ligjore, pretendimet e mëvonshme nuk mund të konsiderohen të bazuara. Prandaj, pretendimi konsiderohet i pabazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa Operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Konstatimet e ekspertit shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 0248/2025 të operatorit ekonomik Eksim Com Sh.P.K

Përgjigje në Pretendimin Ankimor Nr. 1 – Personeli i kërkuar: Pretendimi i operatorit ekonomik ankues lidhet me eliminimin e tij nga procedura e prokurimit për shkak të mungesës së dokumentacionit për 10 punëtorë, konkretisht mungesës së CV-ve dhe kontratave të punës. OE ankues pretendon se ka dorëzuar dokumentacion për 16 punëtorë, përfshirë librezat e punës, fotokopjet e letërnjoftimeve, , si dhe dëshmi nga Regjistri Qendror i Sigurimeve, që vërtetojnë marrëdhënien e punës. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor , analizimit te ofertes dhe krahasimit me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, konstatohet se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar kontratat e punës për të gjithë personelin, siç ka qenë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Sa i përket mungesës së CV-ve, sipas Udhëzuesit për Zbatimin e LPP-së nr. 002/2024, pika 10, Autoriteti Kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime, pasi ky udhëzues parasheh mundësinë për plotësim apo sqarim të informatave në rast të mungesës së CV-së. Megjithatë, mungesa e kontratave të punës nuk është trajtuar si rast për kërkesë sqarimi ne kete udhezues , dhe për këtë arsye përbën mospërmbushje të një kërkese të qartë dhe obligative të dosjes së tenderit, për të cilën përgjegjësia mbetet tek operatori ekonomik. Në cilësinë e ekspertit shqyrtues, konstatohet se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar, pasi edhe pse janë dorëzuar dokumente mbështetëse për një pjesë të stafit, mospërmbushja e kërkesës për dorëzimin e

kontratave të punës për personelin e kërkuar përbën kriter të paplotësuar, duke bërë që Autoriteti Kontraktues të ketë vepruar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me Ligjin për Prokurimin Publik. Andaj ky pretendim ankimor vlersohet i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor Nr. 2 – Personeli i kërkuar: Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor , analizimit te ofertes dhe krahasimit me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, konstatohet se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar kontratat e punës, siç ka qenë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Sa i përket mungesës së CV-ve, sipas Udhëzuesit për Zbatimin e LPP-së nr. 002/2024, pika 10, Autoriteti Kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime, pasi ky udhëzues parasheh mundësinë për plotësim apo sqarim të informatave në rast të mungesës së CV-së. Megjithatë, mungesa e kontratave të punës nuk është trajtuar si rast për kërkesë sqarimi ne kete udhezues , dhe për këtë arsye përbën mospërmbushje të një kërkese të qartë dhe obligative të dosjes së tenderit, për të cilën përgjegjësia mbetet tek operatori ekonomik. Andaj ky pretendim ankimor vlersohet i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor Nr. 3 – Operatori ekonomik ka kundërshtuar vlerësimin e Autoritetit Kontraktues, duke pretenduar se certifikatat e salduesve janë valide pasi janë lëshuar nga një trup i akredituar sipas standardit ISO 9606-1. Pas shqyrtimit të ofertës, u konstatua se certifikatat ishin të skaduara në momentin e dorëzimit të ofertës dhe nuk shoqëroheshin me dokumentacion që dëshmon vazhdimësinë e vlefshmërisë. Sipas standardit ISO 9606-1 dhe nenit 65 të LPP-së, operatori duhet të dëshmojë përmbushjen e kritereve në momentin e ofertimit. Certifikatat e skaduara nuk e përmbushin këtë kërkesë. Pretendimi është i pabazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa Operatori ekonomik nuk është pajtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatoret ekonomik ankuesFabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K., dhe Eksim Com Sh.P.K., dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka

gjetur se ankesat e Operatoreve Ekonomik Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K., dhe Eksim Com Sh.P.K.,., të refuzohen si te pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Riparimi i Kushinetave të Dyfishta në B1&B2 – Tc "Kosova B" Me Nr. Të Prokurimit: "Kek-24-10314-5-2-1".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **Fabrika Veglave Plus Aparateve Elektrike SH.P.K., EKSIM COM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: